



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEQA"

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Motivimi dhe menaxhimi i performancës së punonjësve
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3+0
Vleranëkredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Pejë
Mësimdhënësi i lëndës:	Email: alma.shehu@unhz.eu Mob: +383 (0)49 223 897
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda motivimi dhe menaxhimi i performancës së punonjësve synon [ajisjen e studentëve me dituri të thelluara mbi systemin kompleks të vlerësimit dhe ngritjes permanente të performancës së punonjësve dhe shfrytëzimin e të njëjti për të krijuar një fuqi punëtore më të motivuar dhe më të vetëmotivuar për punë. Kjo disiplinë shkencore duhet të mundësojë aftësimin e studentëve të identifikojnë mundësi praktike për ngritje permanente të shkallës së motivimit dhe satisfacionit nga puna si alternativë për zmadhim të produktivitetit të fuqisë punëtore dhe avancimin permanent të performancës së përgjithëshme të organizatave bashkëkohore të biznesit.
Qëllimet e lëndës:	Si qëllime të posaçme të lëndës mundet të theksohen mesa vijon: ▪ Pajisje e studentëve me njohuri të thelluara mbi natyrën e motivimit dhe mënyrat e valorizimit të motiveve për të ngritur performancën e punonjësve. ▪ Pajisje e studentëve me njohuri të thelluara mbi teoritë klasike dhe bashkëkohore mbi motivimin e punonjësve. ▪ Pajisje e studentëve me njohuri të thelluara mbi satisfacionin nga puna dhe ndërlidhshmërinë e tij me motivimin e punëtorëve.

	▪ Pajisje e studentëve me njohuri të thelluara rreth ndikimit të faktorëve financiar dhe jofinanciar mbi motivimin dhe satisfakcionin nga puna. ▪ Pajisje e studentëve me njohuri të thelluara mbi konceptet teorike të performancës. ▪ Pajisje e studentëve me dije të thelluara mbi mënyrat dhe teknikat për matje të performancës së punonjësve. ▪ Pajisje e studentëve me dituri të thelluara mbi qasjet e ndryshme për menaxhim të performancës së punonjësve. ▪ Pajisje e studentëve me njohuri të thelluara mbi ndikimin e motivimit dhe satisfakcionit të punonjësve në performancën e tyre në punë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	▪ Pajisje e studentëve me aftësi të thelluara mbi natyrën e motivimit, shqyrtuar në kontekst të implementimit të gjetjeve ky[mbi psikologjinë e punëtorit në përditëshmërinë e organizatave bashkëkohore të biznesit. ▪ Aftësim i studentëve që në mënyrë kritike tu qasen teorive klasike dhe bashkëkohore mbi motivimin dhe të njëjtat ti vënë në korelacion me realitetin e funksionimit të organizatave të biznesit në Republikën e Kosovës dhe më gjerë. ▪ Aftësim i studentëve që të ballafaquar me situata reale biznesore të identifikojnë motivet sekondare të punëtorëve dhe të njëjtit ti valorizojnë për të realizuar në performancë më të lartë të fuqisë punëtore. ▪ Aftësim i studentëve të realizojnë matje të shkallës së motivimit të punëtorëve në drejtim të identifikimit të faktorëve që rezultojnë me zvogëlim të shkallës së përgjithëshme të motivimit dhe rritje të shkallës së desatisfakcionit nga puna. ▪ Aftësim i studentëve actual, që nesër të ndodhur në pozitë menaxheriale të ndjekin në mënyrë permanente performancën e punëtorëve individual, grupeve dhe ekipeve të punës dhe fuqisë punëtore në përgjithësi. ▪ Aftësim i studentëve të bëjnë matje të performancës së punënjësve duke zbatuar teknikat bashkëkohore shkencore për matje të performancës. ▪ Aftësim i studentëve që në të ardhmen të ndodhur në pozitë menaxhuese të dijnë si të gjejnë balancing midis kërkesave të punës nga njëra anë dhe kërkesave të punënjësve nga ana tjetër si një hap drejt motivimit të punënjësve për arritje të një performance më të lartë.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë qëduhet tëkorrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithsejt
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	2	5	10
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	10	1	10
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 6 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë		Ngarkesa totale:	150
Metodologjia e mësimëdhënies:	- Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratës, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike, etj. - Prezantimi i temës mësimore në Poëer Point - Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime - Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike te ndërmarrjet prodhuese private e publike dhe te organizatat jofitim prurëse.		
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja dhe aktiviteti 10% Testi i 35% Testi II35% Punimi seminarik20%		
Literatura			
Literatura bazë:			

	1. Adrian Furnham, Motivation and Performance: A Guide to Motivating a Diverse Workforce, 2017. Kogan Page; 1st edition. 2. Michael Armstrong: Menaxhimi i performancës : strategji kyçe dhe udhëzime praktike, Max, Tiranë, 2006
Literatura shtesë:	1. Aubrey C. Daniels, John S. Bailey: Performance Management: Changing Behavior that Drives Organizational Effectiveness, Aubrey Daniels Publications Inc., Atlanta, 2014 2. Herman Aguinis: Performance management, Chicago Business Presss, Chicago, 2019

Plani i dizejnuar i mësimi:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Natyra e motivimit dhe performancës
Java e dytë:	Motivet dhe motivimi
Java e tretë:	Dizejnimi i punëve motivuese
Java e katërt:	Teoritë mbi motivimin
Java e pestë:	Satisfakcioni nga puna
Java e gjashtë:	Shperblimet në funksion të motivimit të punonjësve
Java e shtatë:	Testi i
Java e tetë:	Vlerësimi dhe menaxhimi i performancës së punonjësve
Java e nëntë:	Teknika për vlerësim të performancës së punonjësve
Java e dhjetë:	Procesi i menaxhimit të performancës
Java e njëmbëdhjetë:	Menaxhimi i performancës dhe planifikimi strategjik
Java e dymbëdhjetë:	Menaxhimi i performancës dhe zhvillimi i punonjësve
Java e trembëdhjetë:	Menaxhimi i performancës së ekipeve të punës
Java e katërmëdhjetë:	Motivimi dhe menaxhimi i performancës së punonjësve të biznesit në Republikën e Kosovës

Java e pesëmbëdhjetë:	Test II,(pergaditja per provim)
------------------------------	----------------------------------

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.</i> • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkolloreç • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimoreç • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e mjetit identifikues në teste dhe provimç • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimitç • Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale. • Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.